



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 53**

Datë: 09. 10. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

## **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.50 dhe 51/2017;*

2. Aktivitetet e ZRPP-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimi të vëzhguesve, grupi i gjashtë (VI);*

- *Shqyrtim dhe miratimi i Rekomandimit për anulim të akreditim të vëzhguesve*

3. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

*Shqyrtimi dhe miratimi i tingullit, llogos, slloganit dhe dizajnit për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017;*

4 .Të ndryshme

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Mirë se keni ardh në mbledhjen e 53-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. E keni rendin e ditës. A ka dikush diçka për këtë rend dite me shtuar...? Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Pastaj, ata miratuan procesverbalevt e mbledhjeve të KQZ: 50 dhe 51.

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Enis Halimi:** Sekretariati, ka vijuar me përmbushjen e obligimeve të veta për sa i takon implementimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet lokale 2017, dhe nga mbledhja e fundit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve disa nga aktivitetet janë zhvilluar, dhe disa janë në proces...Përse i takon periudhës së regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta që për shkak të pa aftësive të tyre fizike nuk mund të dalin për të votuar në vendvotimet ku janë caktuar, kjo si periudhë, është realizuar data 23 gusht, deri me datën 7 tetor. Për gjatë kësaj periudhe, 1573 votues që gravitojnë në 34 komuna, janë të paraqitur për regjistrim në këtë kategori. Shpërndarjen sipas komunave, e keni në tabelën faqe numër 1 dhe numër 2. Për sa i takon regjistrimit të votuesve në institucione, ne kemi pranuar të dhënat nga institucionet si kundër mund t'i shihni në faqen numër 3. Bëhet fjalë për qendrat korrektuese dhe burgjet, dhe po ashtu, edhe entin special dhe qendra korrektuese, dhe shtëpia e pleqve në Prishtinë.

Jemi në fazën e përpunimit të të dhënave në mënyrë që t'i identifikojmë vendvotimet për shkak se, ne e dimë se këto janë zgjedhje lokale dhe secila komunë është zonë në vete. Për sa i takon kategorisë së tretë të votuesve me rrethana të veçanta, janë 19 votues dhe atë në komunat Rahovec (17 votues), dhe në Mitrovicë të Jugut (2 votues). Procesi i trajnimit të Komisionarëve pra, ka filluar shpërndarja e materialit dhe pako e trajnimit të doracakëve pra të gjitha materialet dhe është duke si proces i tillë do të ju shpërndajmë edhe planin e trajnimit juve dhe të gjithë palëve të interesuara në mënyrë që të mund të monitorohet. Jemi duke zhvilluar aktivitet jashtëzakonisht intensiv të mbikëqyrjes së trajnimit të komisionarëve, si hallk jashtëzakonisht e rëndësishme për cilësinë e procesit zgjedhorë përgjithësisht.

Po ashtu, tha z. Halimi, edhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, është duke i vijuar aktivitetet që i ka të parapara me plan operacional për këtë fazë të ciklit zgjedhor. Jemi në parapërgatitje pra, në përgatitje të trajnimeve dhe për stafin Ki - votës dhe për stafin e qendrës së numërimeve dhe të rezultateve. Disa softuer që kanë qenë si pilot projekte dhe që për herë të parë që procedohen në këto zgjedhje, janë në fazën e testimit, sikundër është Softueri i skanimit të formulimit të rezultateve dhe i evidentimit të materialit zgjedhor. Po ashtu, edhe nga tereni jemi në kontakte me zyrtarët tanë komunal dhe me komisionet komunale zgjedhore dhe po i

përmbushim të gjitha obligimet që kemi në këtë plan, edhe një mori aktivitete tjera administrative të cilat nuk do të ju ngarkoj. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Faleminderit. A ka dikush ndonjë pyetje? Po, urdhëro Adnan...!

**Adnan Rrustemi:** Trajnimi i komisionarëve ka filluar d.m.th., vetëm po më intereson një feedback, kështu, fillestar për këto trajnimet fillestare...! A kanë ndryshuar nga trajnimet e kaluara, a po monitorohen, cila është pjesëmarrja e komisionarëve d.m.th., a po ka telashe me vijueshmëri...? Këto janë të rëndësishme për ne, dhe e dyta, po më intereson, më tepër po e ngris si çështje kur bëhet fjalë për qendrën e numërimit dhe të rezultateve...Kanë qenë disa rekomandime të dhëna nga vëzhguesit e BE-s të cilat, ne jemi përpjekur me i përfshirë në një plan veprimi: ndryshimi i procedurës për disa aktivitete, e veçmas organizimi fizik i QNR-ës që me b'a sa më të qasshme procedimin e çdo aktiviteti atje, e sidomos numërimin që me pas mundësi vëzhguesit vendor dhe ndërkombëtarë me e përcjellë dhe me e monitoru secilin aktivitet edhe me marr informacione sa më të qarta dhe sa më të sakta. Nuk e di a janë marr masa, apo do të merren në ditët në vazhdim...?

**Ercan Spat:** Unë, kam një pyetje..., më shumë si kërkesë sesa si pyetje. E pash listën e regjistrome për votuesit me nevoja të veçanta...E palogjikshme po më duket: qyteti me madhësi të dytë me numrin e votuesve me veç 1 votues me nevoja të veçanta...! Ndërsa, komunat me nga dy mijë votues, kanë nga 100 e më shumë...! Një anomali po më duket, dhe kisha kërkuar nga Sekretariatit të analizojë dhe të e hulumtojë se mos ka ndonjë gabim teknik, apo diçka tjetër... Faleminderit.

**Adnan Rrustemi:** Veç po më intereson se, a ka ndonjë pengës në aspektin e sigurimit të materialeve të ndryshme për proces zgjedhor. Se, e pash këtu te logjistika bëhet fjalë për përgatitjen e specifikave ose specifikimi i kontratave të caktuar, e është në interes mi e ditë a janë përmbyllur këto, edhe a mundemi me konsideruar që ofrimi i këtyre materialeve është i sigurt për ditën e zgjedhjeve...?

**Enisa Halimi:** Për sa i takon sigurimit të materialit, një pjesë e materialit tashmë është në depot tona, shumica e materialeve...! Ato që na mungojnë dhe kemi pasur probleme me lidhjen e disa kontratave, ka të bëjë me materialin për pako të vendvotimeve. Janë materiale administrative teknike...Kemi pasur disa probleme dhe shty si të tilla për shkak që nuk ka korresponduar cilësia e atyre materialeve të ofruara nga kompanitë, me atë çfarë ne kemi kërkuar. Por, besoj që nuk shohim ndonjë arsye për ndonjë alarm në nivel të lartë për sa i takon mungesës së këtyre materialeve, besoj që në kohë do të vijnë edhe ato në vendin e vet.

Për sa i takon QNR-ës dhe transparencës, thjeshtimit të procedurave etj., ne kemi bërë disa ndryshime sepse, ashtu jemi zotuar dhe akorduar të gjithë këtu për zbatimin e rekomandimeve të vëzhguesve sidomos atyre të vëzhguesve të Bashkimit Evropian. Kemi ndërmarr masa që t'i rrisim kapacitetet absorbuese të materialit gjate procesit zgjedhor dhe po ashtu, edhe ofrojmë maksimalisht transparencë sa më shumë gjatë procedimit të materialit dhe posaçërisht edhe gjatë procesit të numërimit, do të thotë me disa organizime në kuptimin teknik të fjalës...Pra, jemi

akorduar, dhe si kundër e dini, edhe procesi i thjeshtimit të formularëve është proces, pra që është miratuar këtu, dhe besoj do t'i jap një frymë të re gjithë procesit zgjedhor. Për sa i takon aspektit të apo dimensionit të trajnimit ka filluar trajnimi ditën e shtune dhe jemi në proces të grumbullimit të raporteve kthyesë nga të gjitha komunat, jemi në proces të analizimit dhe të fuzionimit të atyre raporteve dhe analizimit të tyre për me qëllim që të krijojmë një ide për vijueshmërinë në këtë rast për mungesat eventuale.

Ka raportime për mbarëvajtje të mirë dhe për interesim të theksuar, tha z. Halimi, sikundër që ka edhe raportime për disa mungesa nëpër ato komuna por, ajo çka është e rëndësishme ka të bëjë me këmbëngulësin tonë që kemi manifestuar edhe prej qendrës por edhe përmes trupave tanë në terren që asnjë komisionar të mos përshihet në procesin zgjedhor si i pa trajnuar. Sa do që eventualisht mund të ketë ndoshta mungesa për shkak të vullnetit apo për shkak orareve të caktuara për shkak se këto zhvillohen në dit pune dhe jo çdo komisionar mund të si të them të bëjë pauzë nga puna në ditën kur është caku, ato lejohen edhe zëvendësimet në ndërkohë por, ajo çka është me rëndësishme është që ne do të tregohemi fanatik në zbatimin e rregullshmërisë në kuptim të mos përfshirjes të asnjë komisionari në proces pa qenë i trajnuar.

**Sabri Hamiti:** Faleminderit kryetare. Unë, kam pak vërejtje faktikisht në këtë shkresë të aktiviteteve, se nga njëherë po na mungon e nga njëherë po bëhet proforma si ky..., që është shumë formal d.m.th., keni aq shumë aktivitete edhe furnizim me ujë. edhe sa herë e keni thirr stafin që për ne nuk është me rëndësi hiq këtu në KQZ-ë...Sa herë e keni thirr stafin edhe shoferët në takim, edhe a jeni furnizuar me ujë a jo, nuk është çështje d.m.th., çështje janë aktivitetet që ne nuk i kemi kërkuar me i zbatuar, aktivitete që ndërliken me zgjedhjet.

Tani, tha z. Hamiti, diku i ke të duplikime..., pjesën të qendra e numërimit...! Po më intereson testimi i softuerit...A ka ndryshuar diçka në softuer të skenimit të formularëve që po testohet...? E dyta, po e shoh që ka shifra që s 'korrespondojnë, unë po e shoh, meqë e paskët dalluar atje Këshillin për Çështje Ligjore që e udhëhoqi unë...Po thoni i ka mbajtur dy mbledhje, kur i ka mbajtur ato dy mbledhje, nuk thotë asgjw ajo punë pse këshillat tona kanë mbajtur mbledhje, e se ato dy mbledhje janë mbajtur apo jo prej raportimit tënd të fundit...? Se këndeje, e keni që mbledhjet e KQZ-ës janë mbajtur 59, kurse janë mbajtur 2 mbledhje të këshillit...!

Nuk thotë asgjw kjo që 2 mbledhje janë mbajtur 10 dite në këtë anë, e mbledhjet e KQZ-së janë 59 prej fillimit të vitit, d.m.th., është totalisht pa sistem...Dhe, nuk ka nevojë m'i qitë të gjitha ato shënime se, ne na duhen aktivitetet që lidhen me zgjedhje dhe jo tjerat...

**Adnan Rrustemi:** Unë pata pyetje për materialet e trajnimit për komisionar. A kemi mundur me ju përmbajt afatit të përcaktuar nga ne...? A keni pas vështirësi në material se, me sa e di unë, në disa komuna ka pasur probleme me materialet për trajnim me doracak, dhe a ju kemi përmbajtur atyre afateve të përcaktuara...? A është dashtë mi shty datat e caktuara nëpër komuna për trajnim për shkak të mungesës së materialeve për trajner...?

**Eshref Vishi:** Kryeshefi e dha një përgjigje të Adnanit pak më herët lidhur me materialet zgjedhore që ka qenë edhe temë mediatike e ditëve të fundit...Tha është shty, dhe se u mundua të saktësoj se është problem me procesin e tenderimit...A është problem komunikimi mes administratës dhe kompanisë...d.m.th., kërkoj sqarime shtesë: ku është problemi, dhe a është

vërtetë problem...? A është problem i zgjidhshëm d.m.th., duke e marrë parasysh edhe afatin kohorë, ditët që po ecin...?

**Adnan Rrustemi:** Veç edhe një pyetje e kam për komisionarët...! Ne, e kemi obligim ligjorë që me bo verifikimin edhe të komisionarëve në koordinim me këshillin gjyqësor të Kosovës për të kaluarën e tyre penale dhe unë e kam pyetjen se a janë verifikuar këta mijëra komisionar që ata që kanë qenë të dënuar për veprat penale në vitet e fundit siç e parasheh ligji mos me mujt me përfshi, kjo është e rëndësishme mendoj se ndërlidhet pak integriteti i zgjedhjeve dhe me profilin e tyre. Është informacion se ke sot me na përcjell po le ta kemi të qartë janë verifikuar s'janë verifikuar, edhe kur bëhet fjalë për këtë raportin që e ofron sekretariati është e thjeshtë ne kemi planin operacional për secilin aktivitet dhe nën aktivitet. Neve na raportoni për nivelin e realizimin e atyre aktiviteteve në plan operacional që i kanë datat kur fillojnë dhe kur përfundojnë, sidomos në mes të dy mbledhjeve të KQZ-ës. Jo raport pune për nën sektorët dhe sektorët, se kemi zgjatur kablo nga kjo zyre në zyrën tjetër, aktiviteti në cilin nivel është si po realizohet, cilat janë pengesat, qka ka sfida etj.

**Valdete Daka:** Isha lidh edhe unë tek trajnimi, i keni informatat nga PZAP-i i keni, ku janë të përfshirë të gjithë ata që kanë qenë të dënuar edhe nga PZAP-i, por edhe të cilëve ju ka ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje...! Po ashtu, e keni edhe për një menaxher që ka ardhur, a është përfshirë apo jo...? Sepse, ai është menaxher i një shkolle dhe i një qendre të votimit, dhe kisha dashtë me ditë që, a është përfshirë...Në fakt, ky vendim i PZAP-it...! A është larguar ai si menaxher apo jo...? A e keni gjet zgjidhjen se, ai duhet të zëvendësohet...?

Enis Halimi: Unë, nuk e kam tash informatën, unë këtu d.m.th., nuk e kam, nuk e kujtoj, nëse është përfshirë gabimisht meqë ka dal që është i ndaluar prej PZAP. Ju siguroj që ai do të sillet këtu për zëvendësim dhe me zgjidhjen adekuate, pra për ta bërë një gjë të tillë... Pra, në PZAP-ë i kemi dërguar këta të komisionarëve, verifikimet për komisionar, për sa i takon problemeve materiale kemi pas nuk është që nuk kemi pas... nuk e kam informatën çka ka kthyer këshilli gjyqësor por, do të ju informoj besoj, problemet me material për sa i takon cilësisë së materialit e kemi pas...Ju e dini që, e kemi ndryshuar doracakun herën e fundit, e kështu me radhë pra, e kemi bërë një shtyjmë sidomos në Mitrovicë, sepse aty kemi pasur problem me një shkollë e cila ka qenë ka qenë në proces të rinovimit por, megjithatë, me një mirëkuptim dhe me një qasje të them mirëkuptuese, kemi arritur në përfundim që të shtyjmë trajnimin për pak kohë. Materialet për sa i takon testimit të formularëve behet fjalë për dy projekte të reja që sivjet kanë me u testuar, kanë me u fut për herë të parë në proces dhe ato pra bëhet fjalë për ato projekte pra që si të tilla po testohen.

**Ilir Gashi:** Edhe unë pajtohem që raportet të mos ngarkohen me gjëra që sidomos në proces zgjedhor, nuk na hyn në punë. Është mirë që Sekretariati raportet t'i bjen ekskluzivisht për punët e veta që i kryen. Transparenca, është e mirë po, nganjëherë edhe në emër të saj po bihen edhe shumë gjëra që nuk janë as tonat as nuk janë pjesë e kohës që duhet trajtuar. Në raport gjithmonë më shumë kam, dëshirë me pa diçka çka ju keni vështirësi edhe çka është mbet pa u bërë edhe që mund të jetë si sfidë deri në ditën e zgjedhjeve dhe jo shumë ato çka janë përfunduar edhe pse ndoshta është mirë me ditë po, sidomos ne duhet mu fokusuar ato çka edhe ju duhet me na informuar eventualisht me ndonjë sfidë që ju, se jeni edhe dy javë më pak se dy javë deri te dita e

zgjedhjeve dhe është mirë mi ditë të gjitha sfidat e mundshme që ju mundemi me pas deri atë ditë. Ke puna edhe e komisionarëve...! Desha veç një pyetje: ende po na thërrasin njerëzit të cilët kanë problem me pagesa edhe kjo kishte me qenë mirë me pa edhe çka është se, s'janë ata të 11 qershorit. Akoma nuk janë të përfundume. Është mirë që si Sekretariat, me ditë çka është në pyetje me i njoftuar njerëzit se pse s'kanë ndodh këto gjëra...! Po shoh që shumë gjëra me rëndësi, veç i keni lidh kontratat...Sa i përket materialet që janë esenciale në ditën e zgjedhjeve, besoj që do të jemi të vëmendshëm që këto të jenë materiale kualitative të cilat, nuk do të na sjellin telashe me 22 tetor...

**Valdete Daka:** Nëse nuk kemi diçka tjetër, vazhdojmë me aspektet e ZRPP-ës.

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së**

#### *1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimi të vëzhguesve, grupi i gjashtë (VI)*

**Miradije Mavriqi:** Faleminderit Kryetare. Të nderuar anëtarë të KQZ-së, Zyra ka përgatitur rekomandimin për akreditimin e vëzhguesve dhe po e quajmë grupin e 6 të vëzhguesve. Deri me 9 tetor janë proceduar kërkesat e 27 organizatave që kanë aplikuar për akreditim dhe atë të një koalicioni 7 parti politike, 1 organizatë joqeveritare vendore dhe 18 medie me gjithsej 840 vëzhgues. Listën e këtyre organizatave e keni në rekomandim, ndërsa emrat e vëzhguesve i keni në CD andaj zyra rekomandon që dokumentacioni i aplikimit për akreditim është i kompletuar konform nenit 54 dhe 55 të ligjit dhe rekomandim për akreditim. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Kush është që të miratohen 840 vëzhgues nga institucione të ndryshme, gjithsej 27. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për akreditimin e vëzhguesve

#### *2. Shqyrtim dhe miratimi i Rekomandimit për anulim të akreditim të vëzhguesve*

**Miradije Mavriqi:** Zyra, gjithashtu ju njofton që pas akreditimit të vëzhguesve të grupit 4 kur janë akredituar për vëzhgimin, ka rezultuar se në ato lista janë 23 kandidat të certifikuar të subjekteve politike, janë akredituar njëherit edhe si vëzhgues të procesit zgjedhor. Duke u bazuar në nenin 55, paragrafi 2 pika a, dhe nenit 55, paragrafi 4 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili parasheh që asnjë person nuk mund të shërbej si vëzhgues zgjedhor nëse është kandidat për post zgjedhor në Kosovë...Pra për këtë, zyra rekomandon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të tërheq akreditimin e vëzhguesve të këtyre personave të cilët figurojnë në listat e kandidatëve të subjekteve politike. Listat e vëzhguesve, i keni gjithashtu në rekomandim, dhe janë 23 emra: 22 janë të partive politike, dhe ky i fundit është një vëzhgues i

cili ka dhënë dorëheqje dhe ka dashur m'u tërheq prej këtij aktiviteti. Subjektet politike të cilat i kanë pranuar këto ID të këtyre vëzhguesve të këtij procesi zgjedhor, janë obliguar që t'i dorëzojnë në zyre këto ID, ose akreditimin e këtyre vëzhguesve.

**Valdete Daka:** Kush është për de akreditim të tyre?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për de akreditimin e këtyre vëzhguesve*

### **3. Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

*Shqyrtimi dhe miratimi i tingullit, llogos, sloganit dhe dizajnit për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017*

**Illir Gahi:** Faleminderit kryetare. Ne, sot e kemi mbajtur mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik. Është një lajm i mirë që më në fund e kemi operatorin dhe, për këto dy javë sa na kanë mbetur do të mundohemi që sa më shumë ta informojmë opinionin rreth procesit të votimit. Ne, sot kemi shqyrtuar tingullin, llogon dhe sloganin si dhe dizajnin për zgjedhje. Po besoj që kompania, është këtu dhe është e gatshme që t'i shfaq në ekran... Ne, sa i përket llogos, si këshill jemi dakorduar për slogan. Kemi dy propozime të cilat, ne mund t'i diskutojmë këtu.

Operatori paraqiti tingullin, llogon dhe sloganin.

Anëtarët e KQZ-së, pas demonstrimit në mënyrë teknike nga operatorin, në parim edhe duke nxitur përmirësime dhe ndërhyrje të rëndësishme, miratuan veç e veç përmes votimit: tingullin, llogon dhe sloganin e Zgjedhjeve Lokale 2017.

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----